



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
NJËSIA E PROKURIMIT

Vlorë më 23.10.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Zyrë Informacioni me një ndalesë-One Stop Shop”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45210000-2 (Punime ndërtimi)

VLERA E FONDIT LIMIT:

7.409.123 (shtatëmilion e katërqind e nëntë mijë e njëqind e njëzet e tre) lek, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta,

formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është **148.183 (një qind e dyzet e tetë mijë e një qind e tetë dhjetë e tre) lekë, të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.***

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- 2.1.1 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të cilësisë së punimeve **ISO 9001 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- 2.1.2 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 14001 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- 2.1.3 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 45001 (e vlefshme)** (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- 2.1.4 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombëtare e licensimit (QKL) Kodi III.2. B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane”. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, date 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44,

pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

Kriteri për licencën e lëshuar nga QKL me kodin III. 2. B është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertoje te jete i pajisur me certifikatat e mesiperme, të lidhura me objektin e prokurimit, gjë e cila krijon bindjen dhe sigurinë të Autoriteti Kontraktor që ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Në seksionin “Kategoria III.2. “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se:“ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihen ndër të tjera edhe transporti i mbetjeve të ngrurta (inerte), gjatë kryerjes së veprimtarisë.

Sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se referuar Preventivit të Punimeve, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka parashikuar kryerjen e punimeve Transport i mbeturinave me auto. Në nenin 5 të ligjit nr.10081datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “ Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Sa më sipër konstatohet se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivit, shfaqet ndër të tjera kryerja e veprimtarisë transporti i mbetjeve i cili referuar kuadrin ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licensuara dhe është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera e xhiros minimale vjetore, duhet të jetë *jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është "Procedure e hapur e Thjeshtuar", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: "vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastiit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare(2020, 2021, 2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet.

Shenim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilancet e njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. (Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin*

ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023. (Në rastet e bashkimitbtëboperatorëve ekonomikë, çdo anëtar I grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB)

Kriteri sipas pikes 2.2.3 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit ku operatorët ekonomike duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas parashikimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, germa b të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2021 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **2.222.736 (dymilion e dyqind e njëzet e dymijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh** dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **7.409.123 (shtatë milion e katërqind e nëntë mijë e njëqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e

bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar,
 - Aktin e kolaudimit;

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posacme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4, germa (a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera limit e kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktor në funksion të kërkesës për të provuar përvojën e mëparshme të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit ka kërkuar që në rastin e paraqitjes

së punëve të ngjashme me kontrata bashkëpunimi ku operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë një përqindje të caktuar dhe zëra specifikë të punës në tërësi ka kërkuar si dokumentacion shoqërues dhe ***kontratën e bashkëpunimit dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit.*** Sqarojmë se për të vërtetuar faktin nëse ky operator ekonomik përmbush punët e ngjashme të kërkuara ky dokumentacion është i nevojshëm për autoritetin kontraktor. Në mbështetje të Nenit 88 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, aktet ligjore parashikojnë formën dhe dokumentacionin e nevojshëm për të ofertuar si bashkim operatorësh ekonomik (kontrata e bashkëpunimit si dhe percaktohen elementet konkrete që do të kryejë secili prej operatorëve ekonomik në bashkëpunim). Pra referuar këtij dokumentacioni përcaktohet saktësisht përqindja dhe elementët konkretë në zëra punimesh që operatori ekonomik ka marrë përsipër të realizojë në këtë kontratë duke i krijuar mundësi autoritetit kontraktor të verifikojë dhe vlerësojë nëse punimet e marra përsipër për tu realizuar në këtë kontratë janë të ngjashme me punimet e kontratës objekt prokurimi. Thënë kjo operatori ekonomik mund të plotësojë vlerën në përqindje të punës që kërkohet të realizohet por ndërkohe në kontratën e realizuar në bashkëpunim mund të mos ketë realizuar zëra të ngjashëm me kontratën objekt prokurimi duke mos provuar përvojën e suksesshme për punë të ngjashme.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zoterojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuar me ligj si më poshtë:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

NP-3 A Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale.

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

NS-1 A Punime për prishjen e ndertimeve.

NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to etj.

N.S -8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri

NS-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi;

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe si dhe ne VKM nr 759, date 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar.

Gjithashtu në mbështetje të Ligjit specifik nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 8 përcaktohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit, në përputhje me standardet kombëtare ose europiane... .”

Kategorite per punimet e ndertimit dhe niveli per cdo kategori punimesh zbatimi jane percaktuar referuar zerave te preventivit te punimeve per kete objekt, projektit te zbatimit si dhe ne mbeshtetje te plote te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.42, date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, (i ndryshuar).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-3	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale.	Koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për ristrukturim ndertese. e Finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.	A	0-20 milion
NS-1	Punime per prishjen e ndertimeve	Punime prishje dhe cmontimi	A	0-20 milion
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to etj	Punime suvatimi dhe veshje punime dritare dhe dyer	A	0-20 milion
NS-8	Ndërtime parafabrikat me	Punime betoni, punime hekur betoni	A	0-20 milion

	beton të armuar, struktura metalike dhe druri			
NS-14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	Punimet te instalimeve elektrike	A	0-20 milion

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik në licencën e shoqërisë për këtë objekt të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, diplomë, CV, Librezat e punës, dhe të figurojnë në listëpagesa (për periudhen Korrik 2023-Shtator 2023) si më poshtë:

- Inxhinier ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier elektrik 1 (një)
- Inxhinier mekanik 1 (një)

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese së inxhinierët e deklaruar në kërkesën 2.3.4 për kualifikim janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Kriteri sipas pikes 2.3.3 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit . Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm inxhinierik referuar zërave të preventivit të objektit per realizimin e kontrates ne mbeshtetje te pikës 4 të Nenit 77 te Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje te Nenit 39 te VKM Nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”*

Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, CV apo qënësia e tyre në listpagesat e shoqërisë, janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se këta drejtues teknikë janë operativë pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf teknik të pajisur me certifikata të sigurimit teknik të leshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Korrik 2023 – Shtator 2023** minimalisht si më poshtë:

- Punonjës Teknik ndërtimi 1 (një)
- Punonjës suvaxhi 1 (nje)
- Punonjës Bojaxhi 1 (nje)
- Punonjës Saldimi 1 (një)
- Punonjës Mekanike 1 (një)
- Punonjës Elektricitistë 2 (dy)
- Punonjës Karpentier 2 (dy)
- Punonjës Pllakashtrues 3 (tre)
- Punonjes Murator 2 (dy)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;
- Certifikate të sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione të autorizuara nga /ish (IQT) e cila të jete e leshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Operatori ekonomik të paraqes deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit marredhenieve punes	Nr. Amzes/ekuivalent diplomes/certifikates profesionale	Institucioni/Subjekti certifikues	Data vlefshmerise se certifikates profesionale

Kriteri sipas pikes 2.3.4 do të përmbushet nga OE me anë të plotësimit të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit dhe tabelës Tab.1. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Stafi teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me punimet që kërkohet të realizohen të cilat janë punime për rikonstruksionin e ndërtesës suvatime, lysterje me boje, punime elektrike, punime shtresash etj. Gjithashtu ky kriter është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

2.3.5 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar si

- a) 1 (një) punonjes i cili të disponojë çertifikatë/deshmi si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", (i ndryshuar), lëshuar nga organizatë shqiptare ose e huaj e njohur në Republikën e Shqipërisë, të shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme,diplome/certifikatë si dhe te figuroje ne list pagesa per periudhen Korrik 2023- Shtator 2023
- b) Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar si: 1(një) Punonjes ekspert zjarrfikës i certifikuar në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi lëshuar nga MZZH.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kriteri sipas gërmes a) është vendosur në mbështetje të Ligjit 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për ndihmën e parë dhe ndërhyrjet ndaj emergjencave dhe ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve.

Kriteri sipas gërmes b) është vendosur në mbështetje të Nenit 39 të ligjit Nr.152/2015" Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin" (i ndryshuar), , citohet: "Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në përdorim e veprave dhe strukturave të ndryshme, ndërtesave, rrjetit

	PUNIME PRISHJE DHE CMONTIMI						
R.121	Prishje suvatimi	m ²	3,3	2.310/1	0.775*1.6=	1.24	4.092
R.98/1	Cmontim dyer dritare	m ²	1,9	2.375/a	2.2*1.6=	3.52	6.688
Analize	Cmontim ndricues perfshire rrjetin perkates elektrik (komplet)	cope	30,0	2.a-123	0.8*1.6=	1.28	38.4
2.37/5a	Transport i mbeturinave me auto deri 5 km	m ³	5,0			5	25
	Shuma A-1	Leke					74.18
	PUNIME BETONI						
R.32	Trare e arkitrare b/a C16/20 h~4m	m ³	0,2	2.119/1a		20.6	4.12
	Shuma A-2	Leke					
	PUNIME HEKURI BETONI						
R.30	F V hekur betoni Ø 6 - 10 mm	ton	0,007	2.166		60	0.42
	Shuma A-3	Leke					
	PUNIME SHTRESASH						
2.324/b	Plintuse druri per sallën , h = 10 cm	ml	55,0			0.35	19.25
	Shuma A-4	Leke					
	PUNIME SUVATIMI DHE VESHJE						
2.273/5	Shtrese pllaka mermeri t = 3cm (pragje dere jashtme)	m ²	1,0			3.12	3.12
R.87/1	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	m ²	4,5	2.310/1		0.755	3.4
Analize	Ndertim tavani dekorative me karton xhes (50x50)	m ²	86,0	3.297/a		2.1	180.6
	Shuma A-5	Leke					187.12
	PUNIME DRITARE DHE DYER						
Analize	F V vetrare alumin termik me dopio xham termik ne hyrje te korridorit te brendshme	m ²	4,5	2.375		2.2	9.9
R.169	F.V. Dere e jashtme druri masiv me spesor mbi 5 cm, cilesi e pare	m ²	2,5	2.383		2	5
	Shuma A-6	Leke					14.9
	PUNIME BOJATISJE						
2.404/1	Lyerje muret e brendshme me boje hidroplastike importi cilesi e I-re	m ²	852,0			0.36	306.72
	Shuma A-7	Leke					
	SHUMA A (A-1 ÷ A-7)	Leke					
	B - PUNIME NDERTIMI (Sistemim i jashtem rampa + shkalle)						
	PUNIME JASHTME						
2.262/4	Shtrese betoni C 16/20 (rampa + hyrja me shkallet)	m ³	5,0			3.46	17.3

2,272	Pllaka te vogla mermeri t=30mm	m ²	2,5			3.12	7.8
2.273/5	Shtrese mermeri t = 30cm (shkallet e jashtme)	m ²	5,5			3.12	17.16
AN+2,412	Parapet rampe me hekur ø h=1m	m ²	6,5	2,412		39.8	258.7
2,401	Boje vaje sipërfaqe metalike	m ²	19,0			1.47	27.93
	Shuma B-1	Leke					328.89
	SHUMA B (B-1)	Leke					
	C - INSTALIME DHE PAJISJET ELEKTRIKE						
	INSTALIME ELEKTRIKE						
2.490/f	F.V Kasete plastike KE me 36 modular (vende)	cope	2,0			4.9	9.8
2.a-105	Automat termo elekt-mag 4P,380V,40 A	cope	1,0			0.5	0.5
2.490/1b	Automat Mag-Termik 16A 2P-220V	cope	8,0			1.3	10.4
2.a-101	Automat Mag-Termik 20A 2P-220V(CELES)	cope	8,0			1	8
2.490/1a	Automat Mag-Termik 10A 2P-220V	cope	10,0			1.3	13
2,487	Kuti derivacioni PT-5	cope	6,0			0.33	1.98
2,487	Kuti derivacioni PT-3	cope	4,0			0.33	1.32
2.485/d	Priza 2P+T 16-25A/250V shuko GEËIS universale	cope	35,0			1	35
2.485/2	F.v Çeles 10A/250V me nje pulle Geëis	cope	13,0			1	13
480/3	Tube P.V.C.fleksibel Ø 22-26	ml	200,0			0.43	86
480/2	Tube P.V.C.fleksibel Ø17-21	ml	150,0			0.43	64.5
2.a-133	Ndricues FL-(1X18)Ë (pllafon)	cope	30,0			1.2	36
2.a-127	Ndricues FL-(2X36)Ë IP-40	cope	1,0			1.5	1.5
2.a-136	Ndricues pllafonier muror 1x60Ë	cope	1,0			1.2	1.2
2.a-131	Ndricues tip plafoniere emergjence 1x18Ë;IP-65	cope	8,0			1.2	9.6
2.481/5	F.V percjelles PV-500 Ø 10 mm2	ml	60,0			0.07	4.2
2.481/4	Percjelles CU-1X6 mm2	ml	100,0			0.07	7
2.481/2	Percjelles CU-1x2.5 mm2	ml	540,0			0.07	37.8
2.481/1	Percjelles CU-1x1.5 mm2	ml	600,0			0.07	42
2. a-106	Automat magneto-termik 380V,40A, 4P,Id=0.03A	cope	1,0			1.5	1.5
2. a-120	Llampe sinjalizimi 220V;1.2Ë	cope	4,0			0.1	0.4
	Shuma C-1	Leke					384.7
	PAJISJE ELEKTRIKE					TOTALI	1320.3
Analize	F. NVR 8 KANALE	cope	1,0				
Analize	F. HARD DISK SATA 4 TERA	cope	2,0			dite pune 8 ore	165.038
Analize	F. KAMER 6 MPX DIXHITALE	cope	5,0				
Analize	F. UPS 2000 VA	cope	1,0			Grafiku i punimeve 45 dite kalendarike/33 dite pune	5.00114
	Shuma C-2	Leke					
	PAJISJE KOMPJUTERIKE						

Analize	Pajisje kompjuter destop 1 Monitor 24	cope	12,0				
Analize	Pajisje fotokopje Profesionale Color	cope	2,0				
Analize	Pajisje TV 4K 55"	cope	2,0				
Analize	Rack 16U	cope	1,0				
Analize	Sëitch 24 Port GB	cope	1,0				
	Shuma C-3	Leke					
	SHUMA C (C-1 ÷ C-2 ÷ C-3)	Leke					
D. PUNIME MOBILIMI							
	Mobilim						
Analize	Mobilim salla one stop shop	cope	1,0				
Analize	Mobilim zyra kordinatoreve te bashkeqeverisjes	cope	1,0				
Analize	Mobilim zyra drejtor informacioni	cope	1,0				
Analize	Mobilim zyra pergjegjes one stop shop	cope	1,0				
Analize	Mobilim arkiva	cope	1,0				
	SHUMA D-1						
	Aksesore mobilimi						
Analize	Karrige zyre veshje plastike me strukture metalike	cope	10,0				
Analize	Karrige plastike transparente me stemen e Bashkise Vlore	cope	20,0				
Analize	Stola pritje 3 vende	cope	5,0				
Analize	Vazo dekorative me gjelberim	cope	7,0				
Analize	Postera muri	cope	4,0				
Analize	Sinjalistike salle	cope	10,0				
	SHUMA D-2	Leke					
	SHUMA D (D-1 ÷ D-2)	Leke					
PERMBLEDHJE							
	PUNIME NDERTIMI (Salla ONE STOP SHOP + 4 Zyrat)						
	PUNIME NDERTIMI (Sistemim i jashtem)						
	INSTALIME ELEKTRIKE						
	PUNIME MOBILIMI						
SHUMA TOTALE (pa tvsh)							
TVSH (20%)							
SHUMA TOTALE me TVSH (Leke)							

Gjithashtu në funksion të realizimit të kontratës janë kerkuar nga autoriteti kontraktor 3 punonjes inxhinier drejtues teknik të shoqerise, 14 punonjes staf teknik i kualifikuar dhe 1 punonjës ekspert zjarrfikës të cilët po ti shtohen numrit të punëtorëve të përcaktuar sipas tabelës përbëjnë numrin në total prej 23 punonjes të nevojshëm për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

- 2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për mobiljet (skrivani me material melamine, dollap me material melamine, komodine me tre sirtare, karrige zyre veshje plastike me strukture metalike, karrige plastike transparente) Per materialet e kerkuara te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikata e cilesise ISO 9001-2015 e prodhuesit me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike. *Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu,si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*
- 2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për paisjet kompjuterike (kompjuter, fotokopje, TV rack,së itch) Per materialet e kerkuara te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatat e cilesise me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike. *Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu,si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”,në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM–së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te verifikojte qe specifikimet teknike te paisjeve te propozuara nga operatoret ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike te përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si certifikatat e cilesise me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike .

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/sherbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe per shkak te interesit te larte qe ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira. Prandaj e gzykojme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar perputhshmerine ne specifikimet teknike te mallrave te kerkuara, por njëkohesisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e standarteve të kërkuara ka parashikuar kërkesen e mësipërme, vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt dhe konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin ne menyre te detajuar karakteristikat teknike të mallarave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet

teknike të kërkuara nga projektuesi. Plotesimi i kerkeses me siper garanton Autoritetin Kontraktor per cilesine dhe standartet e larta nderkombetare dhe te perditesuara sipas teknologjise se re dhe bashkekohore.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamiona vetshkarkues , kapaciteti total mbajtës minimumi 5 ton	në pronësi ose me qera	copë	1
2	Kamioncine me kapaciteti total mbajtes deri 3.5 ton	në pronësi ose me qera	cope	1
3	Depozite uji mbi 1000 litra	në pronësi ose me qera	copë	2
4	Betoniere	në pronësi ose me qera	copë	1
5	Matrapik	në pronësi ose me qera	copë	1
6	Gjenerator	në pronësi ose me qera	copë	2
7	Elektrosaldatrice	në pronësi ose me qera	copë	1
8	Trapan	në pronësi ose me qera	cope	1

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier"(i ndryshuar) me VKM-në nr.563, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndeti për përdorimin e paisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës", dhe VKM-në nr.564, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës" si më poshtë vijon:

- Kokore mbrojtëse minimumi 23 (njëzet e tre) copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 (dy) copë

- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë) copë
 - Karroca dore minimumi 5(pesë) copë
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 (pesë) copë
 - Fikse zjarri 3 (tre) copë
 - Jelekë minimum 23 (njëzet e tre) copë
 - *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshëm), Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme),Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi si dhetë shoqërohet me aktin e pronesisë së qeradhenesit. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- a) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 8. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
 - b) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Këshilli i Qarkut Tiranë (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*
 - c) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, i cili vërteton se operatori ekonomik disponon mjetet sa me siper, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet

kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Grafiku i punimeve të jetë sipas të gjithave zërave të punimeve. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar për çdo ze punimi të kësaj vepre sipas preventivit të hartuara nga projektuesi.

Njesia e prokurimit